

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Duhet të kishim dhe ne shqiptarët qelitë tona në Hagë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/duhet-te-kishim-dhe-ne-shqiptaret-qelite-tona-ne-hage-i586446
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:48:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	07f774a3bc423c7fe28593cc88057f00ca6c7d45d5a394765b417de3559b1285
TEKSTI	2f2df35757fbb28c48d38f6a75586c19170ae94ee532f1afdf2ebe3cd89dc369
PAMJA	a1ea3c23d5e90c00a4d4ddfd93a43da5f243f912c60a9dafbd682a1cb5dffffd7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0630ae64854a8ed8ae52548bc11fbd37069d9ef99e41c87068a2e42e36d469b1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0630ae64854a8ed8ae52548bc11fbd37069d9ef99e41c87068a2e42e36d469b1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



1 e [Duhet të kishim dhe ne shqiptarët qelitë tona në Hagë](#)[Denimi i ish-krereve të UÇK-se, Haxhiu: Lajm trondites per Kosoven, aktgjykimet nuk e rishkruajne dot historine"](#)
fundit

Duhet të kishim dhe ne shqiptarët qelitë tona në Hagë



16 Shtator 2026, 12:44Blog Nga Skënder Minxhozi

Haga foli dhe foli ashtu siç pritej. Plot 81 vite burgim për Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, pas një procesi të gjatë gjashtë vite. Edhe gjykata e Novi Sadit apo e Beogradit nuk do t'i kishte dënuar më rëndë krerët politikë të UÇK dhe të shtetit kosovar.

Një dënim skandaloz që ka brenda vullnetin e shprehur hershëm nga evropianët, që ne shqiptarët t'i bashkoheshim pjesës tjetër të kombësive të ish-Jugosllavisë, jo vetëm si viktima, por edhe si promotorë krimesh lufte. Një gjykim i pisët që ka brenda gjeopolitikën e asaj pjese të Perëndimit që prej dekadash ndjehet i kompleksuar pse ka sulmuar Serbinë. Ato bomba kundër Millosheviçit në vitin e largët 1999 janë në origjinën e një kthese të madhe që politika perëndimore nisi të marrë ndaj Serbisë, e që e shohim edhe sot tek sjellja e buta ndaj Vuçiçit e të tjerëve, përfshirë edhe ndaj nderimeve mortore të një kriminelit lufte si Mlladiç në mbarë Serbinë! Perëndimi dënon Thaçin, Krasniqin, Veselin e Selimin për të bashkuar me dhunë dhe mekanikisht në burgjet e Hagës si mostrën Mlladiç e kriminelë të tjerë lufte, ashtu edhe ata që luftuan kundër krimeve e spastrimit etnik që ai dhe ushtria serbe kryen në hapësirën ish-jugosllave. Zgjidhje më të padrejtë zor se gjen, aq më tepër kur gjithçka thuhet dhe vulozet “në emër të popullit të Kosovës”!

Duhet të kishim dhe ne shqiptarët qelitë tona në Hagë. Përndryshe “pax balcanica” e pas vitit 1999 nuk do të quhej e kryer dhe e plotë sipas vizionit hileqar evropian. Duhet të kishim dhe ne kriminelët tanë në batakun e ish-Jugosllavisë. Duhej një ndjesë finale në distancë ndaj Serbisë, duke e mbushur mozaikun e shperbërjes jugosllave me kombësinë e fundit që nuk ishte dënuar për atë që ndodhi.

Edhe kjo, siç pritej ndodhi. Jemi dhe ne formalisht pjesë e galerisë së turpit të Hagës, me dorën e evropianëve të kompleksuar ndaj Serbisë e Rusisë dhe me gjurmët e gishtave të jo pak shqiptarëve gjakprishur të cilët kujtuan se po fitonin politikisht mbi Hashimin, Kadriun, Jakupin e Rexhepin duke ju përgatitur në errësirë dosje akuzash anonime.

Që të dyja këto palë, secila me axhendën e vet, e gjejnë sot veten të përfshirë në vendimin e trupit gjykues kundër liderëve kosovarë. Që të dyja këto palë ja arritën qëllimit të tyre respektiv. Perëndimorët na përfshinë në listën e krimeve të luftës në ish-Jugosllavi, kurse shqiptarët në fjalë arritën t'i heqin qafe liderët e UÇJK me shpresën se kësioj karrierat e tyre politike do të jenë më të qeta dhe më lehta këtej e tutje.

S'ka miopi më të madhe sesa të mendohet se kjo që ndodhi sot është një dënim individual i katër personave dhe asgjë më tepër. Kosova nuk është më sot ajo që ishte dje. Po paguan haraçin më të rëndë të njollosjes me krime lufte, për pavarësinë që mori 20 vite më parë. Një politikë ekuilibriste kompensimi e padrejtë dhe brutale. Dënimi ndaj katër krerëve të luftës nuk është një dramë personale, por një përbaltje kombëtare. Fitoi linja halucinante e Dik Martit, fitoi pozicioni antishqiptar i Serbisë dhe Rusisë, fituan skuthët shqiptarë që më shumë se imazhin e prestigjin e vendit të tyre, donin dënimin e kundërshtarit. Vendimi i sotëm është një njollë që nuk fshihet kollaj. Por është një njollë që të gjithë e dinë se shqiptarët nuk e meritojnë. Nuk është i pari rrëzim në historinë tonë plot kthesa dhe fatkeqësi. Nuk do të jetë as i fundit. Ky është fati i kombeve të vegjël.

Morali falso...

10:50 Blog / 10 komete

[Ç'na duhet leku i fortë kur nuk ul dot çmimin e naftës?](#)

09:01 Blog / 7 komente

[24 orë para verdiktit](#)

16:25 Blog / 19 komente

[Terrori që vetëm Pupin mund ta shohë](#)

15:34 Blog



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.